



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKIAK**

Lënda: Procesverbal i mbledhjes 10.03, 2022.

Në zbatim të ligjit nr. 39/ 2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak po ju vendosim në dispozicion për miratim procesverbalin e mbledhjes së datës **10.03.2022**.

PROCESVERBAL

I mbajtur sot në datë **10.03.2022**.

Në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Gjirokastrë. Mbledhja jashtë radhe po zhvillohet online. Marrin pjesë në mbledhje 19 anëtarë.

Mungojnë në mbledhje, Armand Feruni, Lorena Gjini Blerta Kallajnxhi. Armand Feruni, Kaliope Rami, Kristi Arapaj, Arjan Hasko, Grusilda Çamani, Merjeme Lengo, Neim Nebiaj, Florika Qafzezi.

Hapet mbledhja nga Z. Lavdi Hasani. Është korumi për fillimin e mbledhjes.

Z. Hasani: Përshëndetje të nderuar këshilltarë! Jemi mbledhur në këtë mbledhje jashtë radhe me kërkesë të Kryetarit të Bashkisë për të shqyrtuar: P/ Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr 107, datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit 2022” me qëllim financimin e objektit “Blerje karburanti për mjete, korrije , ngrohje ” Loti I “Blerje naftë dhe benzinë”. P/Vendim për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për Z. Luigi Soreca.

Z. Hasani: Kjo është një mbledhje jashtë radhe ku situatë që po kalojmë nuk është aspak e zakonshme në lidhje me karburantet. Është zgjeruar flota dhe shërbimi deri në njësitë administrative, prandaj kërkohet të japim zgjidhje për këtë situatë duke mbështetur ekzekutivin.

Z. Brahimi propozon që në mbledhjen e radhës të kemi edhe deputetet e zonës në lidhje me largimin e disa institucioneve të rëndësishme nga qyteti ynë.

Miratohet me 19 vota pro P/Vendim për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” për Z. Luigi Soreca.

Kalohet te pika e dytë. P/ Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr 107, datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit 2022” me qëllim financimin e objektit “Blerje karburanti për mjete, korrije , ngrohje ” Loti I “Blerje naftë dhe benzine”.

Z. Naçi: Situata që kalojmë nuk është normale dhe dinamikat janë në zhvillim.

Z. Gentian Llogo; Kemi kaluar në komision , janë situata të vështira që po kalojmë.

Znj. Rova; Situata të tilla do të kemi në vazhdim dhe do të kemi në vazhdim të cilat mund të na çojnë në ndryshime të vazhdueshme për të realizuar shërbimet.

Z. Golemi; Ju falënderoj për suportin e vazhdueshëm. Kjo naftë nuk është për asnjë shërbim tjetër veç Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunitare dhe utilitare.

Lëvizja e çmimit të Naftës

Në shqyrtim të dokumentacionit të lidhjes së kontratës me objekt “Karburant makine, korrje, ngrohje”, për nevoja të Bashkisë Gjirokastrë është parë lëvizja e çmimit të Naftës dhe Benzinës për periudhën Qershor 2021- Mars 2022.

Çmimi i cili është **prokuruar** në Maj 2021 është **152 Lek nafta dhe 156.4 Lek Benzina**.

	Qershor 2021	Korrik 2021	Gusht 2021	Shtator 2021	Tetor 2021	Nentor 2021	Dhjetor 2021	Janar 2022	Shkurt 2022
Naftë	160.08	166.52	168.75	168.88	175.1	180.55	181.93	188.98	198.56
Beznine	163.08	168.53	174.4	175.6	176	178.36	179.36	189.08	192.36

Kontrata e vitit 2021 ka pasur një vlerë të përllogaritur prej 19.568.782 lek dhe është parashikuar të furnizohet një sasi prej 100 000 litra naftë dhe 10.000 litra benzinë sipas kërkesave të institucionit.

Siç shihet nga tabela më sipër çmimi nga Qershor 2021 deri në Shkurt 2022 ka pësuar një rritje prej afër 40 lek për litër Nafta dhe 30 lek për liter Benzina. Për rrjedhojë Bashkia nuk ka mundur të furnizojë sasinë e kërkuar sipas nevojës (si më sipër).

Bashkia me kontratën e vitit 2021 është furnizuar me një sasi prej 83 962 litra naftë dhe 4 650 litra benzinë.

Hidhet në votë P/ Vendimi për P/ Vendim “Për një ndryshim në vendimin nr 107, datë 24.12.2021 “Për miratimin e buxhetit 2022” me qëllim financimin e objektit “Blerje karburanti për mjete, korrje , ngrohje ” Loti I “Blerje naftë dhe benzinë”.

Miratohet me 19 vota.

Mbyllet mbledhja nga Z. Hasani

Sekretar i Këshillit

Etleva Yzo

KRYETAR I KËSHILLIT

